

FJALA E DEPUTETIT AGRON DUKA

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Së pari, dua t'i bëj një sugjerim maxhorancës. Nuk e di kush e ka shpikur për herë të parë që në fjalimet e ministrave apo të ndonjë një elementi përmendet fjala "fantastike". "Fantastike" do të thotë një zhvillim përrallor, ëndërrimtar, i paimagjinueshëm. Me këtë fantashkencë për 9 vjet ne duhej të kishim shkuar në Mars. Kështu që mendoj se fjala "fantastike" mund të përdoret më shumë nga opozita për çmimet fantastike të inputeve bujqësore, për çmimet fantastike të naftës. Sinqerisht, e kam sugjerim miqësor. Përdoret edhe fjala "galopante! Nuk jemi vend kaq i zhvilluar, sa ministrat përdorin fjalët "fantastik, galopant"! Ne kemi probleme sa të duash.

Pikërisht tani do të flas për bujqësinë, ku duket se, realisht, kemi probleme. Nuk mund të themi ne zhvillim fantastik i bujqësisë, për shembull. Kam dëgjuar ndonjëherë që thuhet se ka zhvillime, por mbetet ende shume për t'u bërë. Kjo është normale, por jo fantastike. Ju lutem, hiqini nga fjalori këto fjalë në fjalimet tuaja. Kështu mendoj unë dhe e kam një sugjerim shumë miqësor. Në fillim të fjalës sime do të doja t'i uroja përfaqësuesit e qeverisë për punën e mirë që po bëjnë për promovimin e bujqësisë, nëse për këtë do të mjaftonin fotot me fermerët nëpër serra, fusha dhe pemëtore, domate kastravec e të tjera. Ishin vërtet të bukura fotot e publikuara para disa ditësh me kultivuesit e qershive, me shportat të mbushura plot me qershi të pjekura.

Ju sugjeroj të shkoni sërish në ato zona për të parë se çfarë po bëjnë fshatarët, sepse sot nuk do të gjeni shporta me qershi të kuqe, por kosha me qershi të kalbura dhe pemë të pavjelura, sepse nuk ka as punëtorë kush t'i vjelë, as treg se ku të shiten. Nuk do të gjeni fshatarë të buzëqeshur, por të dëshpëruar që po u shkon dëm mundi dhe djersa e një viti pune. Dje në mëngjes në Dvoran të Korcës fshatarët dolën në protestë për të denoncuar pikërisht problemin e qershive. Po ju citoj një fermer: "As naftën nuk na e dhanë, as qershia nuk po na shitet, as kumbulla, as molla dhe as gjë prej gjejë. Shikoni si na kanë katandisur me gjilpëra, na kanë stresuar, s'kemi bukë të hamë, e katandisi në mos më keq fshatin". Këto fjalë, që dikujt mund t'i tingëllojnë si migjeniane, i ka thënë një fermer.

Të dashur fermerë shqiptarë,

Për fat të keq, unë jam këtu sot për të mbrojtur projektligjin për disa ndryshime në ligjin “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Them, për fat të keq, pasi ky draft u rrëzua nga maxhoranca qeverisëse në komisione dhe këtu në seancën plenare unë nuk shikoj asnjë shpresë që vota e deputetëve, e atyre që ju keni votuar për t’ju drejtuar, ta shndërrojë atë në ligj. Argumenti me të cilin maxhoranca e rrezoi këtë projektligj ishte: “Megjithëse disa pika të projektligjit mund të merren parasysh, ajo do të bëhet pasi të hartohet plani strategjik 2021-2027”. Domethënë, fermerët shqiptarë duhet të presin hartimin e strategjisë; do të thotë se ata që kultivojnë qershitë, mollët, shalqinjët, domatet dhe kultura të tjera bujqësore, të presin ose të ikin të punojnë në Greqi apo në Maqedoni dhe, kur të mbarojë strategjia, u bëjmë zë e i thërrasim përsëri.

Megjithëse kanë pasur kohë plot 9 vjet për të bërë strategjinë dhe për ta ndryshuar ligjin për bujqësinë, i cili nuk është ndryshuar që nga viti 2007. Në këtë projektligj unë bashkë me sindikatën e fermerëve dhe me shoqatën e fermerëve kemi propozuar zhvillimin e konceptit të ndërhyrjes së qeverisë për stabilizimin e tregjeve. Ky koncept është parashikuar në nenin 11 të ligjit nr.9817/2007, por është një dispozitë, e cila nuk është jetësuar në praktikë, dhe nuk ka akte nënligjore ose ndërhyrje nga data e miratimit të ligjit. Termi “stabilizim i tregjeve” rikonceptohet dhe lidhet fillimisht me studimin e kulturave bujqësore që mbillen, çmimet me të cilat tregtohen në Shqipëri dhe në vende të tjera ku eksportohen produktet shqiptare.

Më konkretisht, parashikohet të ngrihet një agjenci e specializuar në varësi të Ministrisë së Bujqësisë që të kryejë studime dhe të monitorojë ecurinë e prodhimit në sasi, cilësi dhe çmime. Në këtë mënyrë për vitin pasardhës fermerët orientohen për kulturat bujqësore që duhet të mbjellin. Analiza dhe monitorimi do të evitojë mbiprodhimin dhe rritjen e ofertës, e cila destabilizon tregjet për periudha të caktuara të vitit. Është e rëndësishme që ky element të behet nëpërmjet institucioneve të specializuara shtetërore dhe buxheti i shtetit ta përballojë këtë shpenzim. Me ndryshimin e propozuar synohet që në raste të mbiprodhimit për një numër kulturash të caktuara shteti të ndërhyjë dhe ta blejë me çmime tregu produktin bujqësor nga fermerët ose nga operatorët e agropërpunimit, duke stabilizuar tregun.

Konstatohet se çdo vit kultura të ndryshme krijojnë stoqe për shkak të mosfunksionimit të zinxhirit të shitjes dhe konsumit. Kjo kthehet në problem ekonomik për fermerët. Në rastet e mbiprodhimit duhet të këtë masa ndërhyrëse sipas së cilave qeveria blen produktet që më pas përdoren për shtresat në nevojë apo përdoren në institucione që janë konsumatorë të produkteve, si kopshtet, çerdhet, shtëpitë e të moshuarve apo institucionet e vuajtjes së dënimit. Nuk ka asnjë lloj studimi se çfarë duhet të mbjellin dhe ku duhet të mbjellin fermerët. Çfarë kërkon tregu i huaj dhe kush mund të jenë destinacionet eksportuese?

Detyrë e qeverisë nuk është të bëjë foto nëpër serra e pemëtore, por të prodhojë politika orientimi, të këshillojë, të orientojë dhe t'i drejtojë fermerët. Nuk është sukses të prodhosh shumë, sukses është që prodhimin ta shndërrosh në para. Ndokush mund të thotë: po pse shteti duhet t'ua blejë prodhimet e tepërta fshatarëve? Unë them po, se nuk është shpikje shqiptare.

Të dashur kolegë, në fillim të viteve '90, kur Greqia dhe Republika e Maqedonisë nisën problemet e para, pas shkëputjes së kësaj të fundit nga ish-Jugosllavia, u ndërpre eksporti i pjeshkave greke nga rajoni verior që bëhej përmes Maqedonisë. E dini çfarë beri qeveria greke? Bleu të gjithë sasinë e pjeshkave për dy vjet rresht, në mënyrë që fermerët të mos falimentonin, derisa gjeti rrugë të tjera për eksporte. Sot ajo zonë, Vërria quhet, vazhdon të lulëzojë, është një rajon i tërë, me fusha të mëdha ku kultivohet vetëm pjeshka. Sot që ne flasim, atje punojnë edhe fshatarët e Devollit, të cilët i kanë braktisur fushat e tyre të mbjella me mollë, madje disa edhe i kanë prerë pemët, pasi për disa vite me radhë nuk e kanë shitur dot prodhimin.

Projekti i Ballkanit të Hapur do ta vërë bujqësinë tonë përballë konkurrencës shumë të fortë të vendeve të rajonit, nëse realizohet. Ndaj, ne duhet t'i paraprijmë një kapitullimi total të këtij sektori. Ky projektligj mbështet fuqizimin e fermerit, rritjen e sasisë, por, mbi të gjitha, të cilësisë së prodhimeve tona për të konkurruar në tregjet e huaja. Ju e keni para projektligjin e propozuar, por unë po përpiqem të them shkurtimisht dhe nuk do t'ju marr shumë kohë, megjithëse është një temë që detyrimisht nuk mund të flasë shkurt. Së pari, qeveria merr përsipër që skemat kombëtare të mbështetjes, pra subvencionet direkte, të jenë minimalisht 5-vjeçare.

Aktualisht, skemat hartohen dhe zbatohen me baza vjetore dhe vihet re se nuk përfitojnë të gjithë aplikuesit. Duke pasur një afat më të gjatë, ata kanë mundësi t'i planifikojnë më mirë shpenzimet, pra investime te tilla janë më të qëndrueshme. Së dyti, me vendim të Këshillit të Ministrave për çdo vit financiar miratohen kriteret konkrete të përfitimit të subvencioneve. Kjo qasje ligjore do të evitojë që vit pas viti të ndryshohen kriteret dhe sektorët që mbështeten, gjë e cila krijon pasiguri dhe nuk mundëson angazhimin afatgjatë në bujqësi. Së treti, projektligji përcakton një filozofi të re duke sanksionuar heqjen e kritereve përjashtuese të përfitimeve në skemat kombëtare, subvencionet direkte.

Këshilli i Ministrave dhe udhëzimet e ministrit vendosin kriteret, si në numër krerësh për bagëtinë apo sipërfaqe toke, duke përjashtuar fermerët që kanë numër bagëtie të ulet ose sipërfaqe të vogla toke. Projektligji parashikon se nuk do të lejohet vendosja e kritereve të tilla, pra çdo fermer, që punon token apo ushtron aktivitet blegtoral, mund të marrë subvencione. Arsyeimi i qeverisë që në këtë mënyrë të nxisim kooperimin nuk qëndron, sepse nuk është e nevojshme të përjashtohen fermerët e vegjël, por në rastet e kooperimit mund të ketë të masa incentivuese shtesë. Duhet të rritet fondi i subvencionimit, pasi në vitin 2020, për shkak të fondeve të pamjaftueshme, një pjesë e madhe e aplikantëve që plotësonin kriteret nuk përfituan pagesat, pasi fondi buxhetor vjetor ka qenë i limituar.

Ka pasur fermerë që janë skualifikuar vetëm sepse kanë aplikuar disa orë më vonë nga afati. Projektligji parashikon një risi tjetër, që është kryerja e analizave të tokës dhe ujit me shpenzimet e buxhetit të shtetit. Në varësi të strukturës së tokës, përbërjes mekanike dhe kimike të saj varet edhe lloji i kulturave që duhen mbjellë dhe cilësia e prodhimeve, madje këto janë edhe elemente marketimi për produktet. Duhet ta rivendosim bujqësinë mbi baza shkencore, nuk mund të ecim kuturu, duhet të dimë cilësinë dhe përbërjen e tokës, cilësinë dhe përbërjen e ujit për t'i orientuar fermerët se çfarë mund të mbjellin. Miratimi i projektligjit fuqizon dhe zhvillon konceptin e ndërhyrjes për stabilizimin e tregjeve.

Ngritja e një agjencisë në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, për të cilën fola pak më gjatë më lart, është një mbështetje e madhe për bujqësinë: Së pari, për të prodhuar politika orientimi për fermerët; së dyti, për të stabilizuar tregjet në raste mbiprodhimi. Dua t'ju kujtoj sërish nevojën

për t'u konsultuar me shkencën për të pasur një bujqësi të përparuar dhe produktive, si dhe nevojën për t'i orientuar fshatarët dhe për t'i këshilluar ata. Në Lushnjë shumë fshatarë i kanë mbjellë tokat e tyre me mollë, por brenda një dekade ato po thahen, sepse molla nuk e ka aty shtëpinë, por askush nuk u tha atyre që kjo nuk duhet bërë. 15 vjet më parë qeveria shpalli një nismë për mbjelljen e ullinjve, arrave e shegëve. Mbi çfarë baze?

Miliona pemë ulliri janë mbjellë anembanë vendit, nëpër kodra e nëpër fusha, duke zënë edhe tokën e drithërave, duke u mbështetur edhe me fonde qeveritare. Por a na thotë dot kush se ku do të shkojë prodhimi i ullirit apo i vajit të ullirit? Sa nevoja ka konsumi vendas, në cilat vende mund të eksportohet? Në zonën e Dumresë, edhe pse një zonë shekullore kultivuese e duhanit, fshatarët iu drejtuan mbjelljes së ullirit, pasi kishin dështuar me kulturat e tjetra. Gjatë 25 vjetëve të fundit atje janë mbjellë rreth 800 mijë pemë të reja ulliri, por studiuesit e Universitetit Bujqësor të Tiranës sot konstatojnë se pjesa më e madhe tyre nuk janë produktivë, pasi nuk janë varietete që i përshtaten asaj toke e asaj zone.

Shumëkush mund të thotë se vetë i mbollën, çfarë duhet t'i bëjmë tani?! Unë them që jo! Ndaj, njerëzit zgjedhin qeveritë dhe parlamentin, të cilat e kanë detyrë t'i orientojnë ata, në mënyrë që djersa e tyre të mos shkojë dëm. Shërbimi diplomatik përfshihet në mënyrë aktive dhe detyruese në mbrojtjen e interesave ligjore dhe tregtare të eksportuesve shqiptarë. Vitet e fundit është parë një tendence, e cila akoma nuk ka sjellë efektet e synuara, sipas së cilës shërbimi diplomatik merr një rol aktiv në rritjen e eksporteve nga Shqipëria dhe afrimin e investitorëve në Shqipëri. Me pak fjalë propozojmë që ta vëmë politikën në shërbim të ekonomisë dhe jo ekonominë në shërbim të politikës.

Ndryshimet e propozuara nuk pritet të sjellin rritje të shpenzimeve buxhetore, gjithsesi disa shpenzime këtu nuk duhen. Parimet që futen me këto ndryshime, janë të aplikueshme në vende të tjera, nuk ka përplasje me akte të tjera ligjore, nuk kërkojnë shtese personeli apo shpenzime jashtë tavaneve buxhetore. Efektet e pritshme janë shumë pozitive, pasi do të japin mesazhe të qarta që bujqësia është sektor prioritar për vitet në vijim dhe kjo do të sjellë një impakt pozitiv për investimet në bujqësi dhe mbajtjen e më shumë banorëve në fshat që të merren me bujqësi.

Të nderuar kolegë,

Në fshat është vërtetë bukur kur shkon për shëtitje, por fshatrat po braktisen. Në zonat malore dhe kodrinore ky proces po shkon drejt fundit. Sot të gjejmë punëtorë për të punuar në bujqësi, është një sfidë e madhe, sepse nuk ka njerëz, ata i braktisin tokat e tyre dhe shkojnë punojnë në fermat e grekëve dhe maqedonasve, ku me 4 muaj punë sigurojnë mbijetesën e një viti. Unë ju ftoj sot të tregoni vullnetin dhe qartësinë politike për të kontribuar në ndalimin e këtij fenomeni, jo me thirrje, por me vendime konkrete. Këto ndryshime në ligj janë një ndihmë e madhe për këtë çështje. Fshatari sot duhet ta kuptojë se qeverinë e tij, deputetët që ka zgjedhur, i ka në krah për ta mbështetur dhe jo thjesht ta vizitojnë si turistë.

Nuk kuptoj se si njerëz me prejardhje nga zona rurale, deputetë përfaqësues të këtyre zonave të mos votojnë në favor të fermerëve, por sipas orientimit partiak. Kjo, sinqerisht, më duket e pakuptueshme. Si ka mundësi që e gjithë maxhoranca të jetë në bllok kundër me ndryshimet e propozuara thjesht për faktin se nuk është propozuar strategjia? Nuk ka asnjë mendim që të ketë një mendim të kundërt nga ky grupi i maxhorancës? Mendoj se, duke parë situatën, të gjitha pikat e propozuara në projektligj nuk do të kalojnë. Ndoshta besoj se opozita do ta mirëkuptojë dhe do ta votojë projektligjin, por duke qenë në bllok kundër maxhoranca, nuk kalon, por të paktën shpejtojeni strategjinë, kalojini sa më shpejt ndryshimet në ligjin për bujqësinë dhe kaloni ato pika që ju duken interesante dhe shkojnë në favor të bujqësisë.

Është edhe projektligji tjetër që kemi paraqitur me sindikatën e fermerëve dhe me shoqatën e fermerëve, bashkë me këtë projektligj që kemi paraqitur sot, për ndryshimin e skemës së rimbursimit të TVSH-së, pra të bëhet 20 me 20 apo 8 me 8, bëjeni sa të doni, por barazojeni, sepse bujqësia është në rrezik me këtë lloj skeme të rimbursimit të TVSH-së; hiqeni TVSH-në e inputeve bujqësore. Ideja që të përfitojnë disa tregtarë, për mendimin tim, nuk shkon për situatën aktuale. Dihet që shumicën e plehrave kimike dhe inputet bujqësore i kemi të importit. Kur ju keni marrë mendimin vendimin për të vënë TVSH-në ndoshta ka qenë që të përfitonin disa njerëz, por në këto kushte, kur detyrimisht i blejmë më shtrenjtë, janë ngritur të gjitha llojet e kostove. Hiqeni, more burrë, se nuk shkon kjo punë kështu!

Të nderuar kolegë,

Koha nuk pret, nesër mund të jetë shumë vonë. Një njeri i zgjuar ka thënë: “Bujqësia është jashtëzakonisht e lehtë, kur bujku yt është një laps dhe ndodhesh qindra kilometra larg fushës së grurit.” Faleminderit!